

Бр. 03-188/1

30.11

2021 год

ОХРИД

DERI TE

Anëtarët e Këshillit për zhvillim të
Rajonit planor JUGPERËNDIMOR

Kryetar i Komunës së Vevçanit, z. Spase Kočovski
Kryetar i Komunës së Dibrës, z. Hekuran Duka
Kryetar i Komunës së Debërcës, z. Zoran Nogaçeski
Kryetar i Komunës së Kërçovës, z. Fatmir Dehari
Kryetar i Komunës së Makedonski Brodit, z. Zharko Risteski
Kryetar i Komunës së Ohrit, z. Kiril Pecakov
Kryetar i Komunës së Pllasnicës, z. Alija Jaoski
Kryetar i Komunës së Strugës, z. Ramis Merko
I besuari i Qeverisë për Komunën e Qendër Zhupës, z. Arijan Ibrahim

**LËNDA: Ftesë për mbledhjen konstituive të Këshillit për zhvillim të
rajonit planor JUGPERËNDIMOR**

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Në pajtim me kompetencat e Këshillit për zhvillim të rajonit planor, të përcaktuara në Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rregullores për punë të Këshillit, Ju ftojme në mbledhjen konstituive dhe mbledhjen e parë të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

Mbledhja do të mbahet në datë **03.12.2021** (e premte), në sallën e Këshillit të Komunës së Strugës, me fillim në ora **11:00**.

Si shtojcë Ju'a dërgojmë Rendin e ditës për mbledhjet dhe materialet e punës në formë elektronike.

Ju lutemi për prezencën Tuaj duke marrë parasysh rëndësinë e pikave të cilat janë në rend dite.

Paraprkisht Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

Me respekt,

KËSHILLI PËR ZHVILLIM TË
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR
Kryetar i Komunës së Strugës

d-r Ramis Merko, d.v.

Strugë, 30.11.2021.

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal i Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.24/21 dhe 174/21), dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 1 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, e thërras mbledhjen konstituive të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor me këtë

REND DITE

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- 1. Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.
- 2. Zgjedhja e Presidentit të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.
- 3. Të ndryshme

KËSHILLI PËR ZHVILLIM TË
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

Kryetari i Komunës së Strugës,

d-r Ramis Merko, d.v.

Strugë, 30.11.2021

Në bazë të nenit 22, 23 dhe 26 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal i Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.24/21 dhe 174/21), dhe në bazë të nenit 2 dhe nenit 5 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, e thërras mbledhjen e parë të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, me këtë

REND DITE

1. Shqyrtimi i Planit financiar të Qendrës për zhvillim të RPJP për vitin 2022.
2. Propozim - Vendim për miratimin e Planit financiar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2022.
3. Propozim vendim dhe Vendim për autorizimin e Presidentit të Këshillit për zhvillim të RPJP për shpalljen e Thirrjes publike për zgjedhjen e anëtarit- përfaqësuesit në Këshillin për zhvillim të RPJP nga ana e shoqatave në nivel të rajonit dhe për nominimin e anëtarit-përfaqësues nga Bashkësia e biznesit nga rajoni planor.
4. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e anëtarit – përfaqësuesit në Këshillin për zhvillim të RPJP nga shoqatat në nivel të rajonit.
5. Propozim-vendim dhe Vendim për organizimin e shërbimit profesional të Qendrës për zhvillim të RPJP.
6. Informacione në lidhje me projektet rajonale me të cilat Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor aplikoi tek Byroja për zhvillim rajonal për vitin 2021 dhe 2022.
7. Propozim-Vendim dhe Vendim për dhënie në pronësi të punëve dhe mallrave të realizuara në Qendrën për terapi fizikale "Shën Erazmo".
8. Të ndryshme

KËSHILLI PËR ZHVILLIM TË
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

Kryetari i Komunës së Strugës,

d-r Ramis Merko, d.v

Strugë, 30.11.2021